

## **Punëtori tematike në Resnjë**

Më 16 shtator të vitit 2008 në Pretor u mbajt punëtori në temë “Mekanizmat për pjesëmarrje të bashkësive etnike që nuk janë shumicë në krijimin e politikave publike”. Qëllimi i punëtorisë tematike ishte që pjesëmarrësit të fitojnë përvojë praktike për zbatimin e mekanizmave për pjesëmarrje të bashkësive etnike në krijimin e politikave publik.

Punëtorinë e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni për tu përmirësuar statusi i bashkësive etnike në vendin ku jetojnë, të ngrihet vetëdija për pjesëmarrje më të madhe në proceset e vendim prurjes në nivel lokal dhe të përmirësohen marrëdhëniet dhe bashkëpunimi mes bashkësive etnike dhe komunës. Punëtorinë e facilitoi Kire Kitevski, trajnues nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të RM (ZELS). Në punëtori morën pjesë gjithsej 25 përfaqësues, mes tyre 20 vinin nga organizata joqeveritare, kurse pesë veta i përfaqësonin komunat Resnje dhe Manastir.

Pjesëmarrësit në punëtori u njoftuan me mundësitë e dhëna në dispozitat pozitive ligjore për pjesëmarrje të bashkësive që nuk janë shumicë në krijimin e politikave publike – pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe indirekte e qytetarëve në sjelljen e vendimeve për çështje të rëndësishme lokale. Pas kësaj pjesëmarrësit u njoftuan me mekanizmat e posaçëm për pjesëmarrje siç janë: shumica e Badinterit apo e ash.q. veto e pakicave, rolin dhe vendin e komisionit për marrëdhënie mes bashkësive, përdorimi i shkrimit dhe gjuhës së bashkësive, si edhe përfaqësimi i drejtë i të gjithë bashkësive në administratën komunale dhe shërbimet publike. Punëtorja u mundësoi pjesëmarrësve të fitojnë dituri praktike për zbatimin e mekanizmave për pjesëmarrje të bashkësive që nuk janë shumicë në krijimin e politikave publike dhe njëkohësisht diturinë e fituar ta transferojnë në subjekte tjera.

Nga punëtorja u soll konkludim që të organizohen takime të ngjashme edhe në të ardhmen ku do të diskutohet për gjendjen e bashkësive jo shumicë dhe të përgatitet program vjetor i cili do tu dorëzohet Këshillave të komunave me qëllim të përfshirjes së tyre në planin dhe programet vjetore të komunave të Resnjes dhe Manastirit.

Zyra lokale e projektit nga Resnja (Qendra për përkrahje të bashkësive në Resnje, ish qendra për bashkëpunim me OJQ-t) ofroi përkrahje logjistike gjatë organizimit të ngjarjes.